REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT - OPŠTINA ISTOK
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Dales - Izlazna
Nr 001-016 Data 11.08.2014
Br Datum
ISTOG-ISTOK

| Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosovo | KUVENDI I KOMUNËS<br>SKUPŠTINA OPŠTINE<br>MUNICIPAL ASSEMBLY | | Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|---|---|---|---|
| | 01 Nr.52/2014 | Data:<br>18.07.2014 | |

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 germa (i) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 33. pika 8. të Statutit të Komunës, nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më: 18/07/2014, shqyrtoi Listën me emërtime të rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunë së Istogut, të Komisionit Komunal për Emërtimin e Rrugëve dhe Shesheve, mori:

## V E N D I M

I. Anulohet Vendimi 01Nr.28/05, i datës 03.05.2005, i Kuvendit të Komunës për emërtimin e rrugëve dhe shesheve.

II. Miratohet Lista me Emërtimin e Rrugëve dhe Shesheve e propozuar nga Komisioni i Kuvendit të Komunës, për Emërtimin e Rrugëve dhe Shesheve në tërë territorin e Komunës së Istogut. Lista me emrat e rrugëve dhe kodet e rrugëve është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III. Obligohet Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që t'i zbatojë procedurat e përcaktuara në Ligjin për sistemin e adresave, Nr.04/L-071.

IV. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

K r y e s u e s i,
Hazbi Bajra

| Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosovo | KUVENDI I KOMUNËS<br>SKUPŠTINA OPŠTINE<br>MUNICIPAL ASSEMBLY | | Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|---|---|---|---|
| | 01 Nr.49/2016 | Data:<br>29.04.2016 | |

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 pika i) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28, 2008) nenit 33. pika 8. të Statutit të Komunës, nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2016, shqyrtoi Listën me emërtime të rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunë së Istogut, të Komisionit Komunal për Emërtimin e Rrugëve dhe Shesheve, mori:

## VENDIM

I. Bëhet plotësim - ndryshimi i vendimit me 01 Nr.52/2014, i datës 18.07.2014, i Kuvendit të Komunës. Miratohet Lista me Emërtimin e Rrugëve dhe Sheshe e propozuar nga Komisioni i Kuvendit të Komunës, për Emërtimin e Rrugëve dhe Sheshe në tërë territorin e Komunës së Istogut. Lista me emrat e rrugëve dhe kodet e rrugëve është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

II. Obligohet Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që t'i zbatojë procedurat e përcaktuara në Ligjin për sistemin e adresave, Nr.04/L-071.

III. Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe për realizimin e ti ngarkohet Drejtorati për Urbanizëm,Kadastër dhe Mbrojtje.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit,**
**Hazbi Bajra**